

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE
“Outbound Marketing Solution” SH.P.K.

Në këtë statut

-“Ligji” është Ligji Nr.9901, dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”

-“Statuti” është Statuti i Shoqërisë

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria ” **Outbound Marketing Solution**” SH.P.K rregullon pozitën e saj juridike, marrdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjin Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, si dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare.

Neni 1

Data e themelimit

Sot, më 21/06/2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin ” **Outbound Marketing Solution**” SH.P.K.

1- Z. Renols Çupa

NENI 2.

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është: Përpunim te dhënash alfa numerike .

NENI 3.

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do te paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj ” **Outbound Marketing Solution**” SH.P.K.

Selia e shoqërisë ndodhet në Bashkinë Tirane , Adresa Tirane Kashar Yzberisht Rruga Teodor Keko Pallatet Romario ZK 3866, NR PASURI 215/189, N 20,VOL55 fq 225.

NENI 4.

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5.

Regjimi Juridik i Shoqërisë.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të

Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE NENI 6.

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakeve themelues të shoqërisë në përpjestim të drejtë me kuotat që zoterojnë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

NENI 7.

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakeve.

Ortakët japin kontributin në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do të përhapej personave të paautorizuar do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 8.

Abuzimi i ortakeve ndaj shoqërisë

Ortakët e shoqërisë tregtare, që kryen një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;

- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishte pasuri e tij;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë pagueuse të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË NENI 9.

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe paqyrohet në bilancet e saj

NENI 10.

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njqind mije) lek, i ndarë në 1 (1) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 100,000 (njqind mije) lek.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare “Outbound Marketing Solution” SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

2- Ortaku themelues, **Z Renols Çupa zoterues** i 100% të aksioneve.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet që të nënshkruhen në tërësinë e tyre nga Ortakët themelues dhe të shlyhen krejtësisht, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në para ashtu edhe në natyrë. Ato nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime.

NENI 11.

Pronësia mbi kuotat.

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- ◆ shitë-blerjes;

- ◆ trashëgimisë;
- ◆ dhurimit;
- ◆ në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 12.

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve i përbërë nga ortakët themelues të shoqërisë.

NENI 13.
Forma e transferimit

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 14.
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakeve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 15.
Fondet rezerve

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 16.
Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoren nga Ortakët sipas qëllimeve të tij.

NENI 17.
Bilanci

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Asamblese se ortakeve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 18.
Plani financiar.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 19. **Shpërndarja e fitimeve**

Ortakët kanë të drejtë të mbajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 20 **Asambleja e Përgjithshme**

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ortakët e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së eprimitarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 21.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara

NENI 22.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'i dërgohet ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaket janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 23.

Vendim-marrja

Te gjitha vendimet merren nga asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

NENI 24.

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga ortaket dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 25.

Organi administrativ i shoqërisë do të jete me 1 administratore Shtetas Shqiptare **Z. Renols Çupa** me nr 036575741., i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh dhe administratori qëndrojnë në detyrë për periudhën e caktuar nga ortaket në momentin e emërimit ose, në mungesë përcaktimi, deri në dorëheqjen ose shkarkimin e tyre dhe mund të rizgjidhen.

Nuk mund të emërohen në detyrën e administratorit dhe, nëse janë emëruar, duhet të shkarkohen, personat të cilëve u është hequr ose kufizuar aftësia për të vepruar, kanë falimentuar ose u është ndaluar, edhe përkohësisht, e drejta për të ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese pranë personave juridikë, si rrjedhojë e një vendimi penal.

Në rast emërimi për një afat të caktuar, detyra e tyre përfundon në datën e asamblesë së thirrur për miratimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor të mandatit të tyre.

Përfundimi i mandatit të administratorit për shkak të përfundimit të afatit ka efekt nga momenti i riformimit të organit administrativ.

Administratoret te shoqerise **Outbound Marketing Solution** do jete 1 administrator emerohet **Z.Renols Çupa** me te drejta te plota te administratorit .

NENI 26.

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- të thërrasin asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim..

VI. MARRDHËNIET E PUNËS
NENI 27.

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 28.

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI
NENI 29.

Kjo Shoqëri do të prishet në rast kur Asamblea e Përgjithshme vendos për prishjen e Shoqërisë duke emruar nje ose me shume likujdues

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga administratori

VII. DISPOZITA TË FUNDIT
NENI 30.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 31.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 32.

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Renols Çupa

Renols Çupa 